



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS

01. 106/02-14442 2018

Kaçanik.04.04.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit të vetëqeverisjes lokale, Rregulloren (QKR) Nr.13/2017 për riintegrimin e Personave të Riatdhesuar neni 27 pika 1,2,3,4 i kësaj Rregullore, Strategjisë Komunale për riintegrimin e personave të riatdhesuar Kryetari i Komunës merr Këtë :

V E N D I M

I

Themelohet Komisioni Komunal për riintegrim me këtë përbërje:
Diana Reka Drejtoresh e DSHMS-sës, Kryesuese e Komisionit; Fadil Guri (ZKKK); Hajrush Dullovi(DAK); Menduh Krasniqi(DSHP); Hidajete Hoxha(Zyrtare e integrimi Evropiane); Vedat Dema (Zyrtar për të drejtat e njeriut); Jehona Dërvishi (DUKMM)

II

Komisioni komunal për riintegrim merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitime emergjente si dhe masat për mbështetjen e riintegrit të qëndrueshëm sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje

III

Komisioni Komunal për riintegrim duhet të jetë efektiv dhe efikas gjatë ushtrimit të kompetencave për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe të vendos brenda kohës sa më të shkurtë të mundshme por jo më gjatë se 7 ditë nga data e pranimin të kërkesës për skemat emergjente , kurse për skemat tjera vendimet mirren brenda 15 dite nga dita e pranimin të kërkesës.

IV

Me këtë vendim njoftohen Zyra e Kryetarit, antarët e komisionit dhe Zyra Komunale për kthim dhe komunitete

Kryetar i Komunës Kaçanik
z.Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Kaçanik

Datë: 22.05.2018

Nr. 07-104/02-16250/18

Në Mbështetje Të Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike), respektivisht nenit 16 dhe 17 të këtij ligji, nenin 171 Të Ligjit Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare, Udhëzimit Administrativ për Mënyrën e Përfaqësimit të Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.60/01-5056/18 të datës 28.02.2018 si dhe në bazë të procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 21.05.2018 të Komisionit Komunal të Aksionarëve të komunës së Kaçanikut për NPK "Stacioni i Autobusëve" sh.a.Kaçanik ,komisioni ka marrë këtë:

V E N D I M

**Për emërimin e anëtarit të bordit të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Komunale
"Stacioni i Autobusëve" sh.a. Kaçanik**

- I. Emërohet z. **Ramadan Spahiu** anëtar i bordit joekzekutiv të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve" sh.a Kaçanik,
- II. Mandati i të emëruarit është 3 (tri) vite.
- III. Obligohet i emëruari që punën e tij mandatore ta kryej në interes të kompanisë dhe komunës, në përputhje me ligjet e aplikueshme në vend.
- IV. Për punën e vet i emëruari raporton para komisionit komunal të aksionarëve.
- V. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramadush Osmani:

Kryesues i KKA të "Stacioni i Autobusëve" sh.a.Kaçanik

Me këtë vendim njoftohen:

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve, 2. Kuvendi i Komunës 3. Besim Ilazi, kryetar
4. I emëruari z. Ramadan Spahiu 5. NPK "Stacioni i Autobusëve" sh.a Kaçanik dhe 6. Arkivi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	24.05.18	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	01	Numri	400/01-1677-1
Shtojcë			

Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut si dhe Ligjit të buxhetit Nr. 06/L-020 per vitin 2018 Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Neni 1.

Me anë të këtij vendimi i lejohej ndermarrjes transportuese “Elita Tours” që të furnizohet me derivate- naftë deri në 600 litra, me qëllim të bartjes se tifozëve të Klubit Futbollistik Lepenci – Kaçanik në drejtim Kaçanik – Drenas dhe anasjelltas.

Neni 2.

Për sasinë e lejuar sipas pikes 1. të këtij vendimi “Elita Tours” mund të furnizohet me derivate të naftës tek operatori ekonomik, i cili ka kontratë të arritur me K.Kaçanik për furnizim me derivate “Bubeari Petrol” dhe pas furnizimit, obligohet që fletdërgesat në ngarkim ti dorëzoj pranë të Drejtorisë së Administratës Komunale (Zyra e Pranimi të mallrave - faturave) –Kaçanik.

Neni 3.

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, Drejtoria per Arsim,Kulturë, Rini, Sport dhe ndermarrja transportuese “Elita Tours”.



KOMUNA E KAÇANIKUT
Besim Ilazi, Kryetar i komunës